



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 587 Akti

Nr. 656 Vendimi

Tiranë, më 28.4.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli Kryesuese

Xhensila Pine Relatore

Olsi Komici Anëtar

në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datën 27.4.2023, ora 15:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Pali Deçolli, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, z. Pali Deçolli, e dëgjoi atë në seancën dëgjimore në datën 27.4.2023, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Z. Pali Deçolli është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Pali Deçolli i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese komisioneren Firdes Shuli dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Pali Deçolli, për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45-47 e 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në vijim subjektit të rivlerësimit, z. Pali Deçolli, iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve lidhur me sa u kërkua nga Komisioni.

7. Trupi gjykues, pas marrjes së provave dhe shpjegimeve, ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Pali Deçolli, në seancën dëgjimore në datën 27.4.2023, ora 15:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, Tiranë.

I. SEANCA DËGJIMORE

8. Në datën 27.4.2023, ora 15:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit, z. Pali Deçolli dhe vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

8.1 Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 28.4.2023, ora 9:55.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

9. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, z. Pali Deçolli, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

10. Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimet nr. 2 e nr. 17, të vitit 2017, të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore, analizimin e të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat

periodike/vjetore dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, verifikimin e materialeve shkresore të administruara dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për pasuritë e subjektit dhe të personave të lidhur me të, nga i cili ka rezultuar si vijon:

1. Lidhur me apartament banimi me sipërfaqe 110 m², në Durrës

1/a. Faktet nga hetimi administrativ

1.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këtë pasuri të blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 17.6.2003, në vlerën 2.000.000 lekë, duke deklaruar si burim të ardhurat nga paga për periudhën 1996 – 2003.

1.2 Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2003, depozituar pranë ILDKPKI-së në datën 24.5.2004, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri të blerë më 17.6.2003, në shumën 2.000.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga për periudhën 1996 – 2003.

1.3 Drejtoria Vendore e Kadastrës Durrës informoi Komisionin se pasuria “apartament” me sipërfaqe totale 110 m² është regjistruar në pronësi të shtetasit Pali Deçolli, e përfituar me kontratën e shitblerjes datë 19.6.2003.

1.4 Me kontratën e shitblerjes datë 17.6.2003, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasit E. Rr. dhe E. Xh. apartamentin me sip. 110 m², në Lagjen Nr. ***, Durrës, në vlerën 2.000.000 lekë, çmim i shlyer jashtë zyrës noteriale.

1.5 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës informoi se nuk është regjistruar asnjë procedim penal apo mosfillim në ngarkim të shtetasve E. Rr. dhe E. Xh., shitësit e këtij apartamenti, duke provuar mungesën e konfliktit të interesit.

1.5.1 Komisioni kërkoi pranë ASHK-së Drejtoria Vendore Durrës në lidhje me kontratat e shitblerjes për pasurinë e llojit “apartament” në të njëjtën ndërtesë dhe me shkresën kthim përgjigjeje, datë 24.2.2023, ky institucion ka përcjellë kontrata shitblerjeje, ku rezulton se çmimi ishte i njëjtë ose i përafërt me kontratën e lidhur nga subjekti në datën 17.6.2003.

1/a/1. Analizë e burimit të të ardhurave për krijimin e pasurisë dhe mundësia financiare

1.6 Subjekti i rivlerësimit, si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, ka deklaruar si burim për blerjen e kësaj pasurie të ardhurat nga paga për periudhën 1996 – 2003.

1.7 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 7.3.2016, subjekti ka deklaruar: “...ndihmë nga familjarët, përkatësisht nëna dhe vëllai të cilët kanë jetuar në Itali...”.

1.8 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se në kohën e blerjes së këtij apartamenti “me të ardhurat nga pagat, shpërblimet dhe pagesat për orë jashtë orarit për periudhën 1996 – 2003”, ndihma nga familjarët, nëna e vëllai, e deklaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së, ishte kryesisht në mbulimin e shpenzimeve jetësore deri në vitin 2003.

1.9 Subjekti i ka bashkëlidhur pyetësorit: (i) *certificato storico di residenza* për shtetasen L. D., e datës 6.5.2019, lëshuar nga komuna e Barit, dokument i përkthyer dhe i noterizuar; (ii) *certificato storico di residenza* për shtetasin A. D., e datës 6.5.2019, lëshuar nga komuna e Barit, dokument i përkthyer dhe i noterizuar; (iii) *estratto conto previdenziale*, e datës 16.5.2019, lëshuar nga INPS Itali, dokument i përkthyer dhe i noterizuar. Referuar

dokumentacionit të përcjellë për periudhën maj 1999 – dhjetor 2003, vëllai i subjektit ka pasur të ardhura në vlerën 45.711 euro.

1.10 Në bazë të dokumentacionit të administruar nga Komisioni, pavarësisht se familjarët e subjektit kanë pasur mundësi financiare, duket e paqartë koha dhe mënyra e dhënies së kësaj ndihme.

1.11 Sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me:

- kohën dhe mënyrën e pagesës së çmimit dhe çmimin e blerjes, i cili duket se ishte më i ulët se çmimet e referencës së vitit 2003;
- kohën dhe mënyrën e dhënies së ndihmës së deklaruar nga familjarët, nëse ka qenë në vlerë monetare apo materiale.

1/b. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.12 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me kohën dhe mënyrën e pagesës së çmimit në prapësimet e tij, ka parashtruar: *“Pavarësisht se ka kaluar një kohë e gjatë, ju sqaroj që fillimisht për blerjen e këtij apartamenti kam biseduar në vitin 2002 me shtetasin E. Rr. Kemi rënë dakord që vlera e apartamentit të paguhej në momentin kur të lidhej kontrata e shitjes. Para lidhjes së kontratës i kam dhënë cash shumë prej 2.000.000 lekësh, për të cilën duhet të kem marrë një mandat, por që nuk e disponoj për arsye të kohës së gjatë të kaluar. Pasi kemi lidhur kontratën e kam regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës. Këtë pronë unë e kam edhe sot e kësaj dite dhe jetoj me familjen time pa ndërprerje prej rreth 20 vjetësh”*.

1.13 Subjekti i rivlerësimit lidhur me çmimin e blerjes, i cili dukej se ishte më i ulët se çmimet e referencës së vitit 2003, ka parashtruar se: *“Për sa i përket faktit se çmimi i blerjes është më i ulët, ju sqaroj se, siç rezultoi edhe nga kontratat e ngjashme të shitjes së apartamenteve në të njëjtin pallat, të administruara nga Komisioni gjatë këtij procesi, çmimi i shitjes së tyre është i njëjtë me çmimin që unë kam blerë apartamentin dhe besoj nuk ka vend për asnjë lloj dyshimi për një çmim preferencial të blerjes në rastin tim”*.

1.13.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me kohën dhe mënyrën e dhënies së ndihmës së deklaruar nga familjarët, nëse ka qenë në vlerë monetare apo materiale, ka shpjeguar: *“Deri në vitin 2003, unë, nëna dhe vëllai kemi jetuar së bashku në të njëjtën banesë të familjes së origjinës, pavarësisht se nëna dhe vëllai kanë jetuar në pjesën më të madhe të kohës në Itali dhe unë në Durrës. Ndihmesa nga ana e tyre e pjesës më të madhe të shpenzimeve jetësore është një fakt mëse i vërtetë, të cilën unë kurrsesi, për asnjë lloj arsyeje, nuk kam si ta mohoj. Jo të pakta kanë qenë rastet kur nëna dhe vëllai kanë dërguar mallra të ndryshme, si ushqime e pajisje mobilimi shtëpie, nisur kjo nga cilësia dhe çmimet favorizuese, si dhe fakti që kanë pasur banesën në Bari, Itali, pranë portit dhe transporti me traget i këtyre sendeve ka qenë komod”*.

1/c. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.14 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49-50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara nga subjekti, si dhe deklaratimet e tij në seancën dëgjimore – arsyeton se:

1.14.1 Lidhur me mënyrën e pagesës për sa referuar edhe legjislacionit të kohës, kur nuk ka pasur një mënyre pagese të rregulluar nga ligji, shpjegimi i subjektit për pagesën *cash* të bërë shitësit është bindës për trupin gjykues.

1.14.2 Lidhur me çmimin e blerjes së këtij apartamenti nga subjekti, për sa çmimi i blerjes rezultoi i njëjtë me çmimin e apartamenteve të tjera, nuk rezultoi asnjë provë apo fakt që mund të ngrinte dyshime për trajtim preferencial të subjektit të rivlerësimit në këtë rast dhe subjekti nuk ishte gjendur në kushtet e konfliktit të interesave lidhur me shitësit e këtij apartamenti.

1.14.3 Lidhur me ndihmën nga familjarët e tij, trupi gjykues arsyeton se subjekti, si në deklarinimin e interesave në ILDKPKI, deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në përgjigje të pyetësorëve, ka përcaktuar të ardhurat nga paga si burim kryesor të pagesës së çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 110 m², në Lagjen Nr. ***, Durrës.

1.15 Në referencë të dokumentacionit të administruar, subjekti i rivlerësimit rezultoi se ka përfituar të ardhura deri në vitin 2003, që plotësojnë kushtet në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në vlerën 2.475.568 Lekë.

1.16 Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme në vitin 2003, për sa rezultoi se ai ka pasur të ardhura në vlerën 2.475.568 Lekë, dhe shpenzime jetike deri në këtë vit në vlerën 629.303 Lekë duke rezultuar vetëm një diferencë financiare negative prej -153.735 lekësh.

1.17 Lidhur me sa më sipër, Komisioni vlerëson se çfarëdo arsyetimi apo vendimmarrje e subjektit lidhur me ndihmën e pretenduar prej tij si të dhënë nga të afërmit e tij mbi mbulimin e një pjese të shpenzimeve jetësore gjatë viteve 1996 – 2003, nuk do ndikonte në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Pali Deçolli, ka arritur të provojë burimet financiare të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme me të ardhura të ligjshme në vitin 2003.

2. Lidhur me njësi me sipërfaqe 29 m², në rrugën “* ”, Durrës**

2/a. Faktet nga hetimi administrativ

2.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* këtë pasuri njësi, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 29.7.2015, në vlerën 30.000 euro, me burim krijimi depozitën bankare në euro në shumën 24.936 euro dhe depozitën në lekë në shumën 5.064 euro (këmbyer në bankë) në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortes O. D.

2.2 Në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2015, në ndryshim të pasurive dhe burimit të krijimit, subjekti ka deklaruar blerje pasurie njësi me sip. 29 m², në rrugën “***”, Durrës, me nr. pasurie ***, blerë sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 29.7.2015, në shumën 30.000 euro.

2.3 Në bazë të të dhënave nga ASHK Drejtoria Vendore Durrës rezulton e regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë “njësi”, me sipërfaqe totale 29 m², regjistruar me referencë nr. ***, në bashkëpronësi të shtetasve O. D. dhe Pali Deçolli, përfituar me kontratë shitjeje nr. ***, datë 29.7.2015.

2.4 Furnizuesi i Shërbimit Universal, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.8.2020, ka informuar se me gjeneralitetet O. S. D., referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me kontratën e furnizimit nr. ***, në instancën Durrës.

2.5 Me kontratë shitblerjeje njësi nr. ***, datë 29.7.2015, personi i lidhur ka blerë nga shtetasit D. dhe E. P. pasurinë e paluajtshme njësi me sip. 29 m², në rrugën “****”, Durrës, për shumën në total 30.000 euro, e depozituar në llogari të noterit.

2.6 Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, rezulton se në datën 29.7.2015 nga llogaria e personit të lidhur (bashkëshortes) është transferuar në llogarinë e noterit shuma 30.000 euro, me përshkrimin “likuidim sipas kontratës së shitblerjes së datës 29.7.2015, nga O. D.”.

2.7 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës informon se pas verifikimeve të kryera në sistemin elektronik në zyrën e regjistrimit rezulton se nuk është regjistruar procedim penal apo mosfillim në ngarkim të shtetasve D. dhe E. P., që janë shtetasit që ia kanë shitur këtë pasuri bashkëshortes së subjektit.

2/a/1. Analizë e burimit të të ardhurave dhe mundësia financiare

2.8 Në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2015, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e kësaj pasurie depozitën bankare në euro pranë “Raiffeisen Bank” në shumën 24.936 euro, si dhe depozitën bankare pranë “Raiffeisen Bank” në shumën 5.064 euro, në emër të bashkëshortes O. D.

2.9 Në deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur (pjesë e DIPPV-së së vitit 2015), bashkëshortja e subjektit, përveç blerjes së njësisë, ka deklaruar: pakësim depozite në euro në “Raiffeisen Bank” në datën 29.7.2015, në shumën 24.936 euro, me qëllim blerjen e pasurisë; pakësim depozite në lekë në “Raiffeisen Bank” në datën 27.7.2015, në shumën 707.947 lekë, me qëllim këmbim në euro në shumën 5.064 euro, e cila kaloi në llogari në euro, totali i kësaj shume financoi blerjen e pasurisë së sipërcituar.

2.10 Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, rezulton se shuma 30.000 euro e transferuar nga llogaria e personit të lidhur në llogari të noterit në datën 29.7.2015 është krijuar nga kthimi para maturimit në datën 27.7.2015 të depozitës në euro në emër të bashkëshortes së subjektit në këtë bankë, në vlerën 24.936,28 euro, si dhe shumës 5.064 euro prej konvertimit të vlerave monetare në lekë brenda bankës në datën 27.7.2015.

2/a/2. Analiza e burimeve për depozitën në emër të bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”

2.11 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, personi i lidhur ka deklaruar depozitë bankare me afat në “Raiffeisen Bank”, në shumën 23.000 euro, krijuar në datën 8.6.2005, me depozitime në vazhdimësi, me burim krijimi të ardhurat nga paga si mësuese për vitet 1999 – 2009, në shumën 8.000 euro, dhuratë nga prindërit në shumën 5.000 euro dhe të ardhura nga paga e bashkëshortit për periudhën 2003 – 2009, në shumën 10.000 euro.

2.12 Në deklaratimet e interesave për vitet 2012, 2013 dhe 2014, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhurat nga interesat e përfituara nga kjo llogari depozitë (përkatësisht 800 euro, 200 euro dhe 200 euro në vitin 2014).

2.13 Në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 7.3.2016, në përgjigje të pyetjes nr. 3, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me depozitën e bashkëshortes në “Raiffeisen Bank” në shumën 23.000 euro, të deklaruar në vitin 2012, ka shpjeguar se kjo depozitë është hapur që në vitin 2005 nga bashkëshortja dhe është rritur ndër vitet 2006 – 2009. Si burim janë të ardhurat e bashkëshortes dhe subjektit ndër vite, si dhe ndihmë nga familja e bashkëshortes.

2.14 Subjekti ka deklaruar gjithashtu se në shtesat e depozitave, përveç të ardhurave familjare dhe dhuratës nga prindërit e bashkëshortes, kanë qenë edhe dhurata nga të afërm apo familjarë të tij, nëna dhe vëllai, për vajzën e vogël. Pas vitit 2009 kjo depozitë është shtuar vetëm me interesat. Subjekti ka deklaruar se *shtesat e deklaruara prej tij në vitet 2013 - 2014 kanë qenë shtesat nga interesat dhe jo shtesë në depozitë.*

2.15 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se prindërit e bashkëshortes i kanë dhuruar vajzës së tyre dhe njëkohësisht bashkëshortes së subjektit, znj. O. D., shumën 5.000 euro *cash*, rreth muajve qershor - korrik 2007. Këtë shumë bashkëshortja, në dakordësi me subjektin, e ka depozituar në depozitën bankare pranë “Raiffeisen Bank” në datën 24.7.2007.

2.16 Si burim konkret të kësaj shume subjekti deklaron se kanë qenë të ardhurat e tyre familjare të krijuara në vite nga marrëdhëniet e punës dhe biznesi i tyre deri në atë moment. Mbeshtetur në dokumentacionin e administruar, si burim konkret të kësaj shume subjekti deklaron se kanë qenë të ardhurat e tyre familjare të krijuara në vite nga marrëdhëniet e punës dhe biznesi i tyre deri në atë moment. Në lidhje me këtë, subjekti ka sqaruar se vjehrra e tij e ndjerë M. U. ka punuar si ekonomiste e lartë në Durrës, në Ndërmarrjen e Ndërtimit të Porteve Durrës nga viti 1987 deri në vitin 2002, kur kjo ndërmarrje është mbyllur, në subjektin privat “***”, Durrës dhe si kontabël i miratuar me NIPT *** nga viti 2006 deri kur ka ndërruar jetë në vitin 2021, ndërsa vjehrra S. U. ka punuar prej shumë vitesh marinar në Flotën Tregtare Shqiptare me anijen transoqeanike “Tirana” nga viti 1985 deri në vitin 1995, e më pas në të njëjtën detyrë në anije të ndryshme tregtare, në transportin e jashtëm deri në vitin 2002 dhe nga ky vit deri në vitin 2012 si menaxher në subjekte të ndryshme deri në daljen në pension.

2.17 Gjithashtu, nga ana e tij (vjehrrit), nëpërmjet bashkëshortes së subjektit, është bërë me dije se deri në vitin 2001 ka pasur në “Tirana Bank” një shumë prej rreth 20.000 USD, të cilën e ka tërhequr në këtë vit. Në lidhje me këtë fakt, në vitin 2020 ai i ka dhënë edhe një kopje të dokumentit bankar në fjalë. Subjekti ka shpjeguar se nga prindërit e bashkëshortes nuk është krijuar asnjë pasuri e paluajtshme, përveç privatizimit në vitet ‘90 të banesës së tyre në Durrës.

2.18 Komisioni, pasi ka analizuar dokumentacionin ligjor provues mbi të ardhurat e prindërve të bashkëshortes për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, ka arritur në konkluzionin se prindërit e bashkëshortes kanë pasur të ardhura të dokumentuara për të mundësuar dhurimin e shumës prej 5.000 euro në vitin 2007 bashkëshortes së subjektit.

2.19 Në lidhje me ecurinë/shtesat e kësaj depozite në vitet 2012, 2013 dhe 2014, të pasqyruara në analizën financiare vjetore përkatëse, subjekti dhe personi i lidhur kanë arritur të dokumentojnë burimin e deklaruar të të ardhurave për krijimin dhe shtimin e kësaj depozite në emër të bashkëshortes, si një ndër burimet për blerjen e pasurisë së llojit “njësi” në vitin 2015.

2.20 Subjekti ka deklaruar duke analizuar në deklaratën *Vetting* krijimin dhe ecurinë e kësaj llogarie depozitë që nga krijimi dhe deri në fund të vitit 2014, konkretisht:

i. Depozitë bankare pranë “Raiffeisen Bank”, krijuar në datën 29.9.2011, në emër të O. D.. Vlera: 300.000 lekë. Burimi i krijimit: përfitimi i ½ të depozitës bankare pranë BKT-së, si trashëgimtar i nënës sime, të ndjerës L. D.

ii. Shtesë e depozitës bankare pranë “Raiffeisen Bank”, krijuar në datën 2.10.2012 në emër të O. D. Vlera: 200.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura të kursyera nga pagat në familje.

iii. Shtesë e depozitës bankare pranë “Raiffeisen Bank”, krijuar në datën 9.10.2013 në emër të O. D. Vlera: 500.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura të kursyera nga pagat në familje.

iv. Shtesë e depozitës bankare pranë “Raiffeisen Bank”, krijuar në datën 4.11.2014 në emër të O. D. Vlera: 507.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura të kursyera nga pagat në familje.

2.21 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (datë emërimi në detyrë 4.6.2012) personi i lidhur ka deklaruar depozitë bankare me afat në “Raiffeisen Bank”, krijuar në datën 29.9.2011, në shumën 300.000 lekë, me burim krijimi të ardhura nga bashkëshorti si përfitim i ½ të depozitës bankare pranë BKT-së si trashëgimtar i nënës.

2.22 Në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2012, bashkëshortja e subjektit, në deklaratën e personit të lidhur, ka deklaruar shtesë në depozitën bankare me afat në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 200.000 lekë, me burim të ardhura nga paga dhe kursime nga llogaria rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”.

2.23 Në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2013, bashkëshortja e subjektit, në deklaratën e personit të lidhur, ka deklaruar shtesë në depozitën bankare me afat në lekë në “Raiffeisen Bank”, në shumën 500.000 lekë, pa deklaruar burim, por në deklaratën *Vetting* deklararon të ardhura të kursyera nga pagat në familje.

2.24 Në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2014, bashkëshortja e subjektit, në deklaratën e personit të lidhur, ka deklaruar shtesë në depozitën bankare me afat në lekë në “Raiffeisen Bank”, në shumën 506.000 lekë, me burim kursime nga paga, kursime nga paga e bashkëshortit dhe gjendja *cash* e bashkëshortit (ndërsa subjekti deklararon pakësim të gjendjes *cash* në shumën 50.000 lekë).

2.25 Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 29.9.2011 është depozituar *cash* shuma prej 300.000 lekësh dhe në të njëjtën ditë ka kaluar në depozitë me afat 1-vjeçar. Pas kthimit të kësaj depozite në datën 28.9.2012, në vlerën 314.620 lekë, si dhe shtimit në datën 2.10.2012, ka kaluar në depozitë me afat 1-vjeçar shuma 500.000 lekë.

2.26 Në datën 2.10.2013 është kthyer depozita në vlerën 518.675 lekë, në datën 8.10.2013 është kredituar llogaria në shumën 300.000 lekë, si dhe në datën 9.10.2013 është kredituar me transfertë nga llogaria brenda bankës në emër të personit të lidhur shuma 181.000 lekë. Në datën 9.10.2013 ka kaluar në depozitë me afat 1-vjeçar shuma prej 1.000.000 lekësh. Në datën 9.10.2014 është kthyer depozita në shumën 1.009.900 lekë, e cila shtuar me shumën 507.000 lekë të transferuar nga llogaria tjetër brenda bankës; në datën 4.11.2014 shuma 1.517.000 lekë ka hyrë në depozitë me afat, e cila është shlyer në datën 27.7.2015, datë në të cilën bashkëshortja e subjektit ka transferuar me konvertim në euro bankës shumën 707.947 lekë.

2.27 Në datën 15.12.2015 personi i lidhur ka futur në depozitë me afat shumën e mbetur në llogari prej 959.000 lekësh, shumë e cila në mënyrë periodike është ridepozituar deri në datën 15.12.2016, ndërsa në datën 21.12.2016 shuma e depozituar me afat në këtë llogari është 1.167.000 lekë.

2.28 Komisioni, kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2015 - 29.7.2015, për të evidentuar mundësinë financiare për blerjen e pasurisë njësi me sip. 29 m², në Durrës, për shumën 30.000 euro, dhe kryerjen e shpenzimeve për këtë periudhë:

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2015 - 29.7.2015
--

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e subjektit, dokumentuar për periudhën	664.453
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e bashkëshortes, dokumentuar për periudhën	0
Total të ardhura/të hyra financiare	664.453
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	116.688
Shpenzime sigurim mjeti	15.860
Shpenzime shkollimi	38.100
Shpenzime qëndrimi, transporti në Gjirokastrë, për periudhën (deklaruar p. 2)	24.000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI, për periudhën (3 persona)	385.263
Total shpenzime/të dala financiare	579.911
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	120.000
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	4.197.076
Mjete monetare të disponueshme (1)	4.401.618
Blerje pasuri e llojit “njësi” me sip. 29 m ² , në Durrës, në vlerën 30.000 euro	4.118.400
Blerje automjeti tip “****”, në vlerën 120.000 lekë	120.000
Total pasuri	4.238.400
Detyrime financiare	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	4.238.400
Balanca e fondeve (1-2)	163.218

2.29 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti dhe personi i lidhur kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave për blerjen e pasurisë së llojit “njësi” me sip. 29 m², në Durrës, blerjen e automjetit tip “****” në vlerën 120.000 lekë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1.1.2015 – 29.7.2015.

3. Automjet tip “**”, vit prodhimi 2001, blerë në vitin 2012**

3/a. Faktet nga hetimi administrativ

3.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri të blerë me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 19.6.2012, në vlerën 500.000 lekë, me burim krijimi të ardhura *cash* (deklaruar që në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës).

3.2 Në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2012, në ndryshim të pasurive dhe burimit të krijimit, ka deklaruar blerje automjeti tip “****”, me targa ***, në vlerën 500.000 lekë, me burim krijimi të ardhura nga paga për periudhën 1.7.2003 – 1.6.2012 (e deklaruar më parë gjendje *cash*). Gjithashtu, në këtë deklaratë subjekti ka shpjeguar se gjendja *cash* në banesë në datën 31.12.2012 ka pakësim 500.000 lekë dhe shtim 50.000 lekë.

3.3 Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 19.6.2012, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi M. T. automjetin tip “****”, kundrejt çmimit prej 500.000 lekësh, i cili është deklaruar i shlyer jashtë zyrës noteriale.

3.4 Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor në emër të subjektit të rivlerësimit është lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor Durrës në datën 8.8.2012.

3.5 DPSHTRR-ja informon se ky mjet është deklaruar në doganë në datën 3.5.2012 nga shtetasi M. T., në shumën 850 euro dhe janë shlyer shpenzime doganore në vlerën 54.344 lekë.

3/b. Analizë e burimit për krijimin e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

3.6 Në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2012, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e automjetit tip “****” në shumën 500.000 lekë, në datën 19.06.2012, “të ardhurat e kursyera *cash*, deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës”.

3.7 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (datë emërimi në detyrë 4.6.2012), subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 700.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga paga për periudhën 1.7.2003 – 1.6.2012.

3.8 Nga analiza paraprake financiare e kryer nga Komisioni deri në datën 4.6.2012, rezultoi me një mundësi financiare për krijim të gjendjes *cash* në shumën 700.000 lekë, në datën 4.6.2012.

3.9 Komisioni kreu analizën financiare për periudhën nga data e emërimit deri në datën 31.12.2012, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 5.6.2012 – 31.12.2012:

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 5.6.2012 – 31.12.2012	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e subjektit, dokumentuar për periudhën	452.996
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e bashkëshortes, dokumentuar për periudhën	265.141
Të ardhura të përfituara nga pensioni i invaliditetit të nënës së ndjerë	871.600
Të ardhura nga interesa në emër të subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” (në euro)	10.760
Të ardhura nga interesat në llogari pranë “Raiffeisen Bank”, person i lidhur, për periudhën	15.465
Total të ardhura/të hyra financiare	1.615.962
Shpenzime për arsim	28.000
Shpenzime qëndrimi + transporti në Gjirokastrë, për periudhën (deklaruar p. 2)	125.000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI, për periudhën (3 persona)	240.864
Total shpenzime/të dala financiare	393.864
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	450.000
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-1.124.655
Mjete monetare të disponueshme (1)	547.443
Blerje automjeti tip “****” në datën 19.6.2012, në vlerën 500.000 lekë	500.000
Total pasuri	500.000
Detyrime financiare	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	500.000
Balanca e fondeve (1-2)	47.443

3.10 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare nga burime të dokumentuara të të ardhurave për blerjen e automjetit tip “****” në datën 19.6.2012, shtimin e vlerave monetare në llogari bankare kryerje shpenzimesh deklaruar/evidentuar për periudhën deri në datën 31.12.2012.

4. Automjet tip “**”, vit prodhimi 2002**

4/a. Faktet nga hetimi administrativ

4.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri të blerë me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 13.7.2015, në vlerën 120.000 lekë dhe burim krijimi të ardhura nga gjendja *cash*.

4.2 Në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2015, subjekti ka deklaruar blerje automjeti tip “**** ”, vit prodhimi 2002, sipas kontratës datë 18.7.2015, në shumën 120.000 lekë, me burim krijimi të ardhura nga paga dhe gjendje *cash*.

4.3 Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 18.7.2015, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi A. A. automjetin tip “****”, kundrejt çmimit 120.000 lekë.

4.4 Referuar informacionit nga DPSHTRR-ja, rezulton se ky mjet është deklaruar në doganë në datën 22.1.2015 nga shtetasi A. A., në shumën 500 euro dhe janë shlyer shpenzime doganore në vlerën 34.347 lekë.

4.5 Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor në emër të subjektit të rivlerësimit është lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor Durrës në datën 20.7.2015.

4/a/1. Analizë e burimit të të ardhurave si dhe mundësia financiare

4.6 Në deklaratën *Vetting* si burim krijimi për blerjen e kësaj pasurie janë deklaruar kursimet *cash* të deklaruara në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, ndërsa në DIPP-në e vitit 2015, në burim, janë deklaruar të ardhurat nga paga, gjendje *cash*.

4.7 Komisioni mori në analizë ecurinë e gjendjeve *cash* të deklaruara nga subjekti që nga deklarimi i interesave para fillimit të detyrës e deri në datën 31.12.2014, konkretisht: (i) në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, datë 4.6.2012, ka deklaruar *gjendje cash në shumën 700.000 lekë*; (ii) në DIPP-në e vitit 2012 ka deklaruar *gjendje cash 250.000 lekë (pakësim 500.000 lekë dhe shtim 50.000 lekë)*; (iii) në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar *pakësim të gjendjeve cash në vlerën 80.000 lekë*; dhe (iv) në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar *pakësim të gjendjes cash në shumën 50.000 lekë, me destinacion “dhënë bashkëshortes”*.

4.8 Sa më sipër, referuar deklarimeve të subjektit, gjendja *cash* në banesë në datën 31.12.2014 rezulton në vlerën 120.000 lekë.

4.9 Komisionit, lidhur me mundësinë financiare për blerjen e këtij mjeti, pjesë e analizës së kryer për pasurinë e llojit “njësi”, blerë në datën 29.7.2015, i ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi për krijimin e kësaj pasurie në datën 13.7.2015.

4.10 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare nga burime të dokumentuara të të ardhurave për blerjen e automjetit në datën 13.7.2015.

5. Gjendje *cash* në shumën 100.000 lekë

5/a. Faktet nga hetimi administrativ

5.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* likuiditetet *cash* me burim “të ardhurat e kursyera nga pagat në familje”.

5.2 Në deklaram të interesave privatë/periodikë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesa/pakësime, gjendje të likuiditeteve *cash* në banesë. Për periudhën deri më 31.12.2014, gjendjet *cash* të deklaruara janë analizuar më sipër, ndërsa për vitet 2015 dhe 2016 subjekti ka deklaruar, konkretisht:

- në DIPP-në e vitit 2015, shtim të gjendjes *cash* në vlerën 80.000 lekë, me burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes;

- në DIPP-në e vitit 2016, pakësim *cash* në shumën 100.000 lekë (gjendje në datën 31.12.2016 në shumën 100.000 lekë).

5/a/1. Analizë e burimit të të ardhurave për krijimin/shtimin e vlerave monetare *cash*

5.3 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, datë 4.6.2012, subjekti, si burim për krijimin e shumës prej 700.000 lekësh, gjendje *cash*, ka deklaruar të ardhurat nga paga për periudhën 1.7.2003 – 1.6.2012, për të cilat, pas kryerjes së analizës paraprake financiare deri në datën 4.6.2012 rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi nga të ardhura të dokumentuara për krijimin e gjendjeve *cash* në këtë datë.

5.3.1 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar shtim të gjendjes *cash* në vlerën 80.000 lekë, si burim i të ardhurave janë deklaruar “të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes”.

5.3.2 Mbështetur në dokumentacionin e administruar, Komisioni kreu analizën financiare për vitin e mbyllur 2015.

5.4 Trupi gjykues arrin në konkluzioni se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare për shtesën *cash* në shumën 80.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve në harkun kohor 1.1.2015 – 31.12.2015.

5.5 Referuar deklarimeve të subjektit dhe analizës për mundësinë e krijimit të gjendjes *cash*, duket se deri në datën 31.12.2015 gjendja *cash* është në vlerën 200.000 lekë dhe në datën 31.12.2016 është në vlerën 100.000 lekë (pakësuar me 100.000 lekë).

6. Depozitë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, z. Pali Deçolli, në vlerën 15.048 euro

6/a. Faktet nga hetimi administrativ

6.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar duke analizuar krijimin dhe ecurinë e kësaj llogarie depozitë që nga viti 2009 e deri në dorëzimin e kësaj deklarate, konkretisht:

*i. Depozitë bankare në euro pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, krijuar në datën 8.4.2009 në emër të Pali Deçollit. Vlera: 4.000 euro. Burimi i krijimit: e ardhura nga shitja e mjetit tip “***”, me targa ***, sipas kontratës nr. ***, datë 3.2.2009.*

ii. Shtesë në depozitën bankare në euro pranë “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 9.11.2012, në emër të Pali Deçollit. Vlera: 6.244 euro. Burimi i krijimit: përfitimi i 1/2 pjesë të vlerës së pensionit të invaliditetit civil të nënës, të ndjerës L. D., pranë INPS, Bari, Itali.

iii. Shtesë e depozitës bankare pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, krijuar në datën 21.11.2016 në emër të Pali Deçollit. Vlera: 4.300 euro. Burimi i krijimit: të ardhura të kursyera nga pagat në familje.

iv. Shuma totale e depozitës bankare pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, krijuar në datën 8.4.2009 në emër të Pali Deçollit, duke përfshirë edhe interesat e mundshme deri në datën 24.1.2017. Vlera: 15.048 euro.

6.2 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit në deklaram të interesave privatë, pasuri të paluajtshme, të luajtshme, ka deklaruar, ndër të tjera, *depozitë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, krijuar në datën 8.4.2009, shuma 4.000 euro. Burimi i krijimit: të ardhura nga shitja e automjetit tip “***”, me kontratë nr. ***, datë 3.2.2009. Pjesa takuese: 100%.*

6.3 Në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2012, subjekti ka deklaruar shtim depozite në “Intesa Sanpaolo Bank”, në vlerën 6.244 euro.

6.4 Në deklaratën e interesave periodikë/privatë për vitin 2016, në ndryshim të pasurive dhe burimit të krijimit, ndër të tjera, ka deklaruar shtesë në llogarinë depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 4.300 euro, me burim të ardhurat nga kursimet familjare për vitin 2016.

6.5 Referuar të dhënave nga “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se në llogarinë në emër të tij, në euro, në këtë bankë, subjekti ka depozituar *cash* në datën 8.4.2009 shumën 4.000 euro dhe në të njëjtën ditë ka kaluar në depozitë me afat; në datën 9.11.2012 është maturuar depozita në shumën 4.362,24 euro, si dhe është depozituar *cash* nga subjekti shuma prej 6.000 euro, me përshkrimin “kursime familjare”, në të njëjtën ditë ka kaluar në depozitë me afat shuma 10.244 euro; në datën 19.11.2014 është maturuar depozita në vlerën 10.244 euro dhe shtuar pjesë nga interesat është mbyllur në depozitë me afat në të njëjtën ditë shuma 10.758 euro; në datën 21.11.2016 është transferuar shuma 10.803,61 euro, si dhe është depozituar *cash* nga subjekti shuma 4.300 euro, me përshkrimin “kursime nga puna”. Në datën 21.11.2016 ka kaluar në depozitë me afat shuma 15.048 euro.

6/a/1. Analizë e burimit për krijimin, shtimin e vlerave monetare në këtë depozitë

6.6 Në kohën e krijimit të depozitës në datën 8.4.2009

6.6.1 Në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (datë emërimi në detyrë 4.6.2012), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të depozitës bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” shumën 4.000 euro, në datën 8.4.2009, të ardhura nga shitja e automjetit tip “****”, me kontratën nr. ***, datë 3.2.2009.

6.6.2 Me kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 3.2.200, subjekti i rivlerësimit i ka shitur shtetasit K. Xh. automjetin tip “****”, vit prodhimi 1994, kundrejt çmimit 4.000 euro.

6.6.3 DPSHTRR-ja informon se ky automjet është blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 5.1.2005, në shumën 250.000 lekë.

6.6.4 Referuar deklaratës noteriale të datës 30.12.2004, rezultojnë detyrime doganore në vlerën 193.549 lekë.

6.6.5 Në përgjigje të pyetësorit të datës 31.3.2023, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar ndër të tjera se bisedimet për blerjen e këtij automjeti kanë filluar në javën e fundit të muajit dhjetor 2004, ku ka rënë dakord me shitësin që çmimi i blerjes, në gjendjen faktike, të ishte në shumën 250.000 lekë, duke marrë parasysh edhe faktin që automjeti kishte nevojë për disa rregullime e ndërrime të disa pjesëve, duhej paguar detyrimi doganor e më pas targimi i tij. Në datën 30.12.2004 është paguar në Degën e Doganës Durrës vlera e zhdoganimit të këtij automjeti, e cila, së bashku me shpenzimet doganore, ka qenë në një vlerë përafërsisht rreth 200.000 lekë.

6.6.6 Subjekti, më tej, deklaroi se vlera e këtij automjeti deri më datën 5.1.2005 ka kushtuar rreth 480.000 lekë (duke përfshirë vlerën e automjetit, pagesën e detyrimit doganor dhe rregullimet e kryera), vlerë e cila është kryer nga të ardhurat e tij familjare të vitit 2004.

6.6.7 Subjekti ka depozituar : (i) leje qarkullimi datë 7.1.2005 të automjetit tip “****”, me targa ***, (ii) deklaratë doganore nr. ***, datë 30.12.2004.

6.6.8 Sa më sipër, mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe në deklaratimet e subjektit, duke marrë parasysh ndikimin e ndryshimeve të kurseve të këmbimit (vitet 2005 – 2009) në

mbulim të një pjese të amortizimit nga përdorimi i këtij automjeti, nga Komisioni u vlerësua që të pasqyrohet si shpenzim në analizën paraprake financiare shuma prej 480.000 lekësh, gjithashtu e njëjta shumë si e përfitur nga shitja e këtij automjeti në vitin 2009, pra në analizën e kryer deri në datën 4.6.2012 nuk pasqyrohet asnjë vlerë e ardhur shtesë nga shitblerja e tij.

6.7 Shtim depozite në vitet 2012 dhe 2016

6.7.1 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe në deklaratimet e subjektit, kreu analizën financiare për vitet 2012 dhe 2016, për të evidentuar mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur për shtim të likuiditeteve në llogaritë bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për periudhën, nga ku rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur ka pasur burime të dokumentuara të ardhurash për të justifikuar shtimin e likuiditeteve në llogari bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për këtë periudhë.

7. Analiza e treguesve financiarë

7.1 Nga analiza e përgjithshme e treguesve financiarë të kryer nga Komisioni mbështetur në dokumentacionin e disponuar, si dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të dokumentuara për blerje/krijim të pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara ndër vite.

Konkluzioni i Komisionit për kontrollin e pasurisë

8. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

8.1 Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si institucion kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin nr. *** prot., datë 21.11.2017, i cili me vendimin nr. ***, datë 7.7.2020, të KDZH-së është deklasifikuar plotësisht, ku informon se:

10. Subjekti i rivlerësimit, z. Pali Deçolli, ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës. Për subjektin e rivlerësimit, z. Pali V. Deçolli, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.

10.1 Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Pali V. Deçolli.

11. Komisioni mori informacion të përditësuar në lidhje me kontrollin e figurës së subjektit dhe mbas verifikimeve rezultoi se nuk disponohen të dhëna për subjektin e rivlerësimit.

Konkluzioni i Komisionit për kontrollin e figurës

12. Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Pali Deçolli, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

12.1 Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Pali Deçolli, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

13. Vlerësimi i aftësive profesionale është kryer për subjektin e rivlerësimit nga institucioni ndihmës Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky vlerësim është kryer mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e tri dokumenteve të paraqitura nga vetë subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura bazuar në sistemin rastësor.

C/1. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

13.1 Dokumenti ligjor “vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. ***” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës – subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në datën 24.3.2015, ka përpiluar vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin nr. ***, me të pandehur B. B. dhe kallëzues N. Gj. për veprën penale “kanosje”. Nga Grupi i Punës pas analizimit nuk janë konstatuar problematika.

13.2 Dokumenti ligjor “kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier” – subjekti i rivlerësimit ka përpiluar kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, me kallëzues shtetasen R. M. dhe të pandehur shtetasin R. F. për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit D. T. Nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika.

13.3 Dokumenti ligjor “konkluzione përfundimtare për procedimin penal nr. ***, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet”. Konkluzionet i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, të cilat janë përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit. Pas deklarimit të mbyllur të hetimit gjyqësor, subjekti ka paraqitur konkluzionet përfundimtare, ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit F. P. për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim, si dhe në aplikim të neneve 30/1 dhe 35/2 të Kodit Penal t’i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për 5 vjet. Nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika.

PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Dosja 1 – kallëzimi penal nr. ***, datë 21.11.2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 18.12.2013.

Në datën 14.11.2013 shërbimet e policisë janë njoftuar për një dëmtim prone, konkretisht në një shkollë të fshatit Lazarat, Gjirokastrë. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes ka rezultuar se ish-in dëmtuar disa dyer të klasave. Në funksion të hetimit është kryer ekspertimi vlerësues i dëmit të shkaktuar, nga ku është konkluduar shifra 7.000 lekë. Pas administrimit të materialit kallëzues, nga ana e prokurorit është vlerësuar se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit.

Rezulton se nuk ka pasur ankim ndaj vendimit të mosfillimit. Nga Grupi i Punës pas analizimit nuk janë konstatuar problematika.

Dosja 2 – procedimi penal nr. ***, datë regjistrimi 14.1.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Vendim “Për pushimin e procedimit penal”, datë 12.5.2014.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, mbi bazën e kallëzimit të shtetasës S. N., ka bërë regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal. Në këtë kallëzim penal shtetasja deklaron se nëpërmjet thirrjeve telefonike dhe sms-ve është shqetësuar në mënyrë të vazhdueshme nga shtetasja A. M. Për sa më lart, në datën 12.5.2014, subjekti i rivlerësimit ka përpiluar “Vendimin për pushimin e çështjes”, në mbështetje të nenit 328, pika 1, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale, ku ka vendosur që të pushojë çështjen penale nr. ***, viti 2014, për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal. Vendimi t’u njoftohet shtetasve. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit. Nga Grupi i Punës pas analizimit nuk janë konstatuar problematika.

Dosja 3 – procedimi penal nr. ***, datë regjistrimi 2.9.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Vendim “Për pushimin e procedimit penal”, nr. ***.

Në datën 30.8.2014 shërbimet e policisë kanë marrë dijeni se në Spitalin Rajonal të Gjirokastrës kishte shkuar i plagosur me thikë shtetasi K. E., banues në qytetin e M. Nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore janë shoqëruar personeli i lokalit dhe pronari, të cilët janë pyetur mbi rrethanat e ngjarjes. Si pasojë kishte mbetur i plagosur me thikë shtetasi K. E. Si autor i ngjarjes është identifikuar shtetasi R. K. Nga hetimet e kryera nuk është bërë e mundur gjetja e automjetit me të cilin është realizuar plagosja e, në këto kushte, nuk mund të konkludohet sa i përket ekzistencës së veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve të ftohta”. Neni 284 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit. Për sa më lart, më 10.11.2014, subjekti ka përpiluar “Vendimin për pushimin e çështjes”, në mbështetje të nenit 328, pika 1, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale, ku ka vendosur të pushojë çështjen penale nr. *** të vitit 2014, për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Nga Grupi i Punës pas analizimit të dokumentacionit nuk janë konstatuar problematika.

Dosja 4 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 1.4.2015, për veprën penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Dokumenti ligjor – kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. ****”, hartuar nga subjekti i rivlerësimit. I pandehur në këtë procedim është shtetasi F. Gj. Në mbështetje të neneve 400, 401, 228, 229, 244, 251, 258, 259 dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka përpiluar kërkesën për vleftësimin dhe

caktimin e masës së sigurimit, si dhe atë të gjyqimit të çështjes ndaj të pandehurit F. Gj.

Sa rezulton, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 3.4.2015, ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit F. Gj. për kryerjen e veprës penale “drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 muaj burgim, bazuar në nenin 406/ të Kodit Penal t’i ulet 1/3 e dënimit.* Nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika.

Dosja 5 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 5.3.2015, për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit K. R. Dokumenti ligjor – kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. ***”, hartuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka kërkuar *deklarimin fajtor të të pandehurit K. R. për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim, bazuar në nenin 406 të Kodit Penal t’i ulet 1/3 e dënimit.* Rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 20.3.2015, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit K. R. për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim, bazuar në nenin 406 të Kodit Penal t’i ulet 1/3 e dënimit. Grupi i Punës pas analizimit nuk ka konstatuar problematika.

ANALIZA E GJETJEVE

14. Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Pali Deçolli, shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor. Aktet e përpiluara paraqiten të qarta dhe të kuptueshme.

15. Në aspektin profesional rezulton se ka shfaqur aftësi të mira në interpretimin e ligjit dhe arsytimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar qartë ato. Është pjesëmarrës aktiv në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit profesional.

16. Konstatohet se prokurori Pali Deçolli është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune, duke treguar efektivitet në marrjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore.

17. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave, që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

18. Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Pali Deçolli, ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

19. Subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementeve të veprës penale. Në procedimet penale, për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është realizuar drejtimi i hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimeve penale. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësitë e nevojshme mbi kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim.

20. Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në ushtrim të kompetencave ligjore, ka aftësi për të administruar dosjet.

21. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

22. Në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Pali Deçolli. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar.

23. Gjithashtu, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

24. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet pesë dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në procedimin penal.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e aftësive profesionale

25. Trupi gjykues, bazuar në: (i) argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit; (ii) gjetjet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Pali Deçolli, ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

DENONCIMET

26. Pranë Komisionit janë paraqitur 6 denoncime nga të cilat denoncimet e shtetasve: (1) G. T, regjistruar me nr. *** prot., datë 20.3.2018; (2) B. K., regjistruar me nr. *** prot., datë 20.9.2018; (3) V. Ç. regjistruar me nr. *** prot., datë 20.9.2018, nuk përmbushin kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk kanë depozituar dokumentacion provues. Për tri denoncime të tjera Komisioni vlerësoi t’i kërkojë subjektit të japë shpjegime, si vijon:

26.1 Denoncim i shtetasit K. H., regjistruar me nr. *** prot., datë 20.12.2022, regjistruar me nr. ***, datë 15.2.2022, regjistruar me nr. *** prot., datë 9.5.2022, regjistruar me nr. *** prot., datë 18.11.2022. Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të tre prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, midis tyre edhe subjekti i rivlerësimit, pasi ndaj tij prokuroria ka ngritur akuzën “vrasje me dashje”.

26.1.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në shpjegimet e tij subjekti deklaroi se: *“Si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019, ndër të tjera, u dëmtua rëndë një nga godinat e Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Brendshme, ku për pasojë gjeti vdekjen i ndjeri B. H., me detyrë pedagog në ***.*

*Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar kryesisht procedimin penal nr. *** dhe ka kryer hetime në funksion të këtij procedimi në lidhje me objektet e dëmtuara, ku për pasojë*

kanë gjetur vdekjen 23 persona. Hetimet janë ndjekur nga unë dhe dy kolegë të mi, si dhe nga një numër relativisht i madh i Oficerëve të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjithashtu, janë regjistruar dhe ndjekur hetimet në lidhje me dëmtimet e objekteve në mbi 300 procedime të veçanta. Pas kryerjes së hetimeve, konkretisht në procedimin penal nr. ***, organi procedues, ndër të tjerë, ka vendosur të marrë në cilësinë e të pandehurit shtetasin K. H., duke e akuzuar për veprën penale 'shpërdorim detyre', parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, pas kërkesës sonë, me vendimin nr. ***, datë 2.2.2021, ndër të tjera, ka vendosur dërgimin në gjyq edhe të të pandehurit K. H. për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Aktualisht, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës vazhdon gjykimi i kësaj çështjeje, me procedurën e gjykimit të zakonshëm dhe, konkretisht, për të pandehurin K. H. organi procedues ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe dënimin e tij për veprën e kryer dhe aktualisht jemi në pritje të vendimit të gjykatës”.

26.1.3 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, nisur nga rrethanat e çështjes, vlerëson se: Vendimi për vleftësim ndalimi dhe caktim mase sigurimi nr. ***, datë 17.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të ndalimit të datës 14.12.2019 të personit nën hetim K. H., i dyshuar për veprën penale “vrasje me dashje”, caktimin e masës “arrest me burg”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 30.12.2019.

Me vendimin nr. ***, datë 2.2.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur: Dërgimin e çështjes për gjykim, me palë kërkuese Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e përfaqësuar nga prokurorët M. K., E. K. dhe Pali Deçolli me disa të pandehur, midis të cilëve edhe shtetasi K. H., akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kjo çështje është dërguar në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Për sa kohë kjo çështje është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, vendosi që në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të mos shtrihet ndaj çështjeve ende në shqyrtim.

26.2 Denoncim i banorëve të pallatit nr. *,** Lagjja Nr. ***, rruga “****”, Durrës, regjistruar me nr. *** prot., datë 31.1.2022, regjistruar me nr. *** prot., datë 2.2.2022, regjistruar me nr. *** prot., datë 2.2.2022, regjistruar me nr. *** prot., datë 1.2.2022. Këta banorë kanë shprehur shqetësimin për ecurinë e hetimeve për pallatin e tyre, duke hasur pengesa nga Drejtuesja e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe prokurorët e çështjes E. B. e Pali Deçolli. Ata pretendojnë shkelje nga Bashkia Durrës dhe firma e ndërtimit.

26.2.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me këtë denoncim, subjekti sqaron: “Rezulton se pallati në fjalë është ndërtuar nga subjekti ‘***’ dhe pas tërmetit të datës 26.11.2019 ka marrë dëmtime të shumta. Që në momentet e para, në lidhje me dëmtimet e këtij pallati dhe procedurën e ndjekur nga ana e subjekteve ndërtuese dhe institucioneve shtetërore, organi procedues ka vendosur të regjistrojë procedimin penal nr. ***, i cili nuk ka qenë në ndjekje nga ana ime. Pas kallëzimit të avokatit të banorëve të këtij pallati në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kjo e fundit ka kaluar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit

*Gjyqësor Durrës këtë material. Me short më është caktuar mua si prokuror për ta ndjekur këtë material. Pas studimit të materialit kam vendosur të regjistrojë procedimin penal nr. ***. Në vijim ky procedim penal është bashkuar me procedimin penal nr. ***, i regjistruar mbi bazë të kallëzimit të shtetasve A. dhe Sh. K., banorë të këtij pallati. Pas kryerjes së veprimeve hetimore është konkluduar që duke qenë se faktet për të cilat po hetohet në dy procedimet penale ishin të njëjta është vendosur bashkimi i këtyre procedimeve penale në një të vetëm, atë me nr. ***, procedim i cili aktualisht është në hetim dhe për shkak të bashkimit të procedimeve ndiqet nga një prokuror tjetër dhe jo nga unë”.*

26.2.2 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues i Komisionit konstatoi se kjo çështje është duke u hetuar nga një prokuror tjetër dhe në këto kushte nuk ka të bëjë një vlerësim të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Denoncimi i mësipërm nuk i plotëson kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

26.3 Denoncim i shtetasit N. D., regjistruar me nr. *** prot., datë 1.12.2017, i cili denoncon disa subjekte, midis tyre edhe subjektin e rivlerësimit. Pretendon se prokurorët në bashkëpunim me ish-kryetarin e komunës, Komisionin e Verifikimit të Titujve të Pronësisë, ish-prefektin Xh. B. dhe drejtorin A. D., hartografin e ZVRPP-së Fier, kanë kryer të gjitha veprimet për falsifikim, fshehje, zhdukje të produkteve të veprës penale dhe vazhdojnë të njëjtat veprime me kryetaren e Bashkisë Roskovec.

26.3.1 Qëndrimi i subjekti të rivlerësimit

Në lidhje me këtë denoncim subjekti sqaron se: *“Shtetasi N. D. pretendon se janë 21 vendime të dhëna nga 9 prokurorë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ndër të cilët edhe unë. Konkretisht, unë, me vendimet përkatëse, kam vendosur mosfillimin e procedimit penal për materialet kallëzuese nr. *** dhe ***, të regjistruara në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier. Argumentimi ligjor i përdorur prej meje ka qenë se faktet e kallëzuara nga shtetasi në fjalë përbëjnë “gjë të gjykuar”, pasi ato janë hetuar më parë në kuadër të procedimit penal nr. ***. Vendimet në fjalë i janë komunikuar rregullisht kallëzuesit, i cili siç rezulton edhe nga materialet e dosjes së procesit të rivlerësimit, ndër të tjera, për procedurën e ndjekur nga ana jonë si prokurorë ka kallëzuar në Prokurorinë e Përgjithshme. Kjo e fundit e ka dërguar për kompetencë këtë kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku nga ana e prokurorit të caktuar për këtë material (jo unë) është vendosur mosfillimi i procedimit penal nr. ***. Në dijeninë time ky vendim nuk është ankimuar nga kallëzuesi”.*

26.3.2 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Çështja i referohet konfliktit që ky denoncues ka me një qytet tjetër në lidhje me pronësinë mbi një sipërfaqe toke. Në dokumentacionin e bashkëlidhur denoncimit ky qytetar ka dërguar disa vendime për pushimin e çështjes dhe mosfillimin e procedimit penal, të nxjerra nga disa subjekte rivlerësimi në kuadër të procedimit penal nr. ***. Në vitin 2015 çështja objekt hetimi regjistrohet përsëri në Prokurorinë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila ka vendosur mosfillimin e procedimit penal pasi kjo çështje përbën “gjë të gjykuar” me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Bazuar në këto rrethana dhe fakte, Komisioni nuk konstaton shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

Qëndrimi i Komisionit mbi denoncimet

27. Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet, sipas ligjit nr. 84/2016, si dhe shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit, z. Pali Deçolli, dhe nuk gjeti elemente që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo cenojnë figurën e prokurorit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Pali Deçolli:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në bazë të nenit 51, germës “a” e pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Pali Deçolli, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 28.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana

